



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 8.11.2023

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2022”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 8 nëntor 2023, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2022”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Projektligji u shqyrtua sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë projektligj, z. Vullnet Sinaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar:

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre;
- Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;
- Z. Nikolla Lera, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit;
- Znj. Kesjana Halili, Drejtore e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror;
- Znj. Aurela Velo, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit;
- Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Programimit Makroekonomik;
- Z. Fran Brahim, Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore;
- Z. Etugert Llazi, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Z. Arben Shehu, Kryetar;
- Znj. Valbona Gaxha, Sekretare e Përgjithshme;
- Znj. Marjola Llanaj, Drejtore e Përgjithshme;
- Z. Gjovalin Preçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit;
- Z. Qeram Cibaku, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore.

II. Baza ligjore.

Shqyrtimi i projektligjit për miratimin e buxhetit faktik të vitit të mëparshëm është një procedurë e konsoliduar ndër vite, e cila mbështetet në:

- nenet 158 dhe 164 të Kushtetutës;
- nenin 63 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- nenin 31 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar;
- ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78, 83, pika 1 dhe 158 të Kushtetutës.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

Qëllimi i projektligjit është miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2022. Ky raport përmban informacione, statistika dhe analiza të detajuara mbi pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, zbatimin e buxhetit vjetor, borxhin publik dhe përbërjen e tij, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, si dhe situatën e kontrollit të brendshëm publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Projektligji dhe Raporti i Këshillit të Ministrave shoqërohen me Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2022, i cili pasqyron opinionin e këtij institucioni për përputhshmërinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Raporti i KLSH përmban një analizë të hollësishme të situatës makroekonomike e fiskale të vitit të mëparshëm, buxhetit vjetor, borxhit publik, si dhe përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Opinionin e KLSH bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga ky institucion në institucionet e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njësitë e tjera publike. Në këtë raport KLSH pasqyron edhe masat dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

IV. Diskutimi në Komision.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë paraqiti projektligjin, duke u ndalur në realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë gjatë vitit 2022.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, paraqiti raportin e këtij institucioni mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2022.

Relatori paraqiti opinionin e tij për projektligjin, si dhe për raportet respektive të Këshillit të Ministrave dhe KLSH mbi zbatimin e buxhetit faktik të vitit 2022. Ai analizoi realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë për vitin 2022, të krahasuar me periodat e mëparshme dhe me planin, si dhe faktorët kryesorë ndikues.

Relatori theksoi se buxheti i vitit 2022 u ndryshua me 4 akte normative të Këshillit të Ministrave, të cilat kishin qëllim mbështetjen buxhetore për sektorin e energjisë elektrike, financimin e paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, mbështetjen e shtresave në nevojë, mbështetjen e sektorit të transportit publik dhe sektorit të bujqësisë, si dhe kryerjen e investimeve në disa sektorë prioritarë të ekonomisë.

Më tej, relatori paraqiti disa nga karakteristikat kryesore të situatës ekonomike e buxhetore për vitin 2022, si më poshtë:

1. Vazhdimi i trendit pozitiv të rritjes ekonomike.

Gjatë vitit 2022 ekonomia e vendit u përball me pasojat ekonomike e financiare të agresionit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, i cili shkaktoi goditjen e tretë të njëpasnjëshme, pas goditjeve të tërmetit dhe pandemisë gjatë viteve 2020-2021.

Ky argesion solli goditje globale të ofertës në energji dhe mallra të tjerë bazë, të cilat u reflektuan në:

- Rritje të çmimeve të ushqimeve, naftës dhe energjisë në të gjitha tregjet botërore;
- Rritje të pasigurisë së agjentëve ekonomikë e financiarë;
- Rritje të kostove të përgjithshme të financimit.

Krahas këtyre faktorëve, ekonomia e vendit u ndikua negativisht edhe nga situata jo e mirë hidrike e vitit 2022, veçanërisht duke u krahasuar me një vit më parë.

Megjithatë, ekonomia shqiptare ruajti qëndrueshmërinë e ekuilibrave makroekonomikë e financiarë, dinamizmin dhe fleksibilitetin, si rezultat i zbatimit të politikave të drejta fiskale e monetare, si dhe vazhdimit të reformave strukturore në sektorët prioritarë të ekonomisë.

Rritja ekonomike për vitin 2022 ishte 4.8 për qind dhe u mbështet nga:

- Zgjerimi i konsumit familjar;
- Rritja e investimeve të biznesit;
- Rritja e eksporteve.

Nga pikëpamja e ofertës, sektorët kryesorë që kontribuan më shumë në rritjen ekonomike ishin ndërtimi, tregtia, transporti dhe turizmi. Rritje pozitive kanë pasur edhe sektorët e tjerë, me përjashtim të energjisë elektrike. Bujqësia pati rritje të ngadaltë, për shkak të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe vendase.

Rritja ekonomike në vendin tonë ishte më e lartë se rritja mesatare ekonomike në Ballkanin Perëndimor.

2. Përmirësimet në tregun e punës.

Rritja e kërkesës për mallra dhe shërbime u pasqyrua në përmirësime të dukshme në tregun e punës. Norma e papunësisë arriti nivelin mesatar vjetor prej 11.3 për qind. Shkalla e punësimit u rrit me 4.2 për qind. Paga mesatare u rrit me 10.8 për qind, duke arritur nivelin rreth 66 mijë lekë në fund të vitit 2022. Këto zhvillime ndihmuan në rritjen e të ardhurave të familjeve, duke amortizuar shtrenjtimin e kostos së jetesës për një pjesë të madhe të tyre.

Në krahasim me vendet e rajonit, shkalla e papunësisë në vendin tonë ishte ndër më të ulëtat (vetëm Serbia kishte normë më të ulët papunësie).

3. Thellimi i konsolidimit fiskal.

Viti 2022 u karakterizua nga thellimi i mëtejshëm i konsolidimit fiskal, gjë që pasqyrohet nëpërmjet treguesve deficitit buxhetor dhe borxhit publik, si më poshtë:

Deficiti buxhetor u reduktua nga 4.6 për qind e PBB në vitin 2021, në 3.7 për qind të PBB në vitin 2022.

Borxhi publik u reduktua nga 74.5 për qind e PBB në vitin 2021, në 64.6 për qind të PBB në vitin 2022. Borxhi publik ishte më i ulët se pritshmëritë fillestare prej 78.8 për qind e PBB.

Rënia e borxhit publik në raport me PBB në vitin 2022, krahasuar me një vit më parë, ka ardhur kryesisht nga dy faktorë:

- Rritja e PBB me 278,3 miliardë lekë në vitin 2022, krahasuar me një vit më parë;
- Reduktimi i nivelit të stokut të borxhit në vlerë nominale (4.3 miliardë lekë më pak në fund të vitit 2022, në krahasim me një vit më parë).

Efekti i kursit të këmbimit në portofolin e borxhit, të shprehur në valutë, ishte 31.7 miliardë lekë ose 1.5 për qind e PBB.

Borxhi publik, gjatë vitit 2022, u menaxhua në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raportit ndërmjet kostos dhe risqeve.

4. Ndjekja e një politike monetare normalizuese, të harmonizuar me politikën fiskale.

Niveli mesatar i inflacionit, gjatë vitit 2022, arriti 6.7 për qind, duke u ndikuar nga:

- Rritja e shpejtë e çmimeve të artikujve të importit;
- Rritja e kërkesës agregate të brendshme;
- Rritja e kostove të prodhimit vendas.

Rritja e intensitetit dhe zgjerimi i bazës së presioneve inflacioniste diktuan ndryshimin e kursit të politikës monetare, duke kaluar në normalizimin e politikës monetare nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë.

Politika monetare e ndjekur u reflektua në tregjet financiare, duke frenuar inflacionin dhe vendosur atë në një trajektore rënëse, duke arritur nivelin 4.1 për qind në muajin shtator 2023.

Stoku i kredive bankare u rrit me 7.1 për qind në krahasim me vitin 2021, ku peshën kryesore e zë rritja e kredisë për bizneset. Me rritje rezultoi edhe kredia për individët.

Kreditë me probleme u reduktuan me 5.1 për qind në fund të vitit, krahasuar me një vit më parë. Ky reduktim ishte rrjedhojë e masave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, si dhe e përmirësimit të ambientit ekonomik dhe gjendjes financiare të kredimarrësve. Kursi i këmbimit ndaj valutave kryesore ka qenë përgjithësisht i stabilizuar.

5. Rritja mbi parashikimet e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të konsoliduar, për vitin 2022, ishin 572.8 miliardë lekë dhe përbënin 26.8 për qind të PBB. Këto të ardhura:

- Në krahasim me planin, u realizuan në masën 98.2 për qind;
- Në krahasim me një vit më parë, u rritën me 62 miliardë lekë ose 12.1 pikë përqindje.

Kjo ecuri e të ardhurave u ndikua nga:

- ecuria pozitive e ekonomisë, ku një peshë të rëndësishme kishte rritja e të ardhurave nga turizmi;
- rritja e çmimeve të të gjithë produkteve, veçanërisht e energjisë elektrike dhe karburantit;
- politikat fiskale të zbatuara gjatë vitit 2022.

Politikat fiskale.

Politikat fiskale të vitit 2022 synuan sigurimin e një taksimi të drejtë, të balancuar, që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë.

Paketa fiskale e vitit 2022 solli:

- rishikimin e normave të reduktuara dhe përjashtimeve tatimore, veçanërisht lidhur me tatimet indirekte, bazuar në rekomandimet e FMN, duke synuar vendosjen e një sistemi tatimor të barabartë dhe gjithëpërfshirës, si dhe shmangjen e hapësirave për abuzime;
- lehtësimin e barrës tatimore për të punësuarit lidhur me tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

Sipas grupeve kryesore, realizimi i të ardhurave është si më poshtë:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat* përbëjnë peshën kryesore, 68.2 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Vërehet rritje nga 66 për qind, në 68.2 për qind e peshës specifike që zenë të ardhurat nga tatimet dhe doganat në të ardhurat e përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura përbëjnë 18.3 për qind të PBB.

Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura u rritën me 52.8 miliardë lekë ose 15.6 për qind. Në krahasim me planin, këto të ardhura u realizuan në masën 98.2 për qind, me një mosrealizim prej 7.1 miliardë lekësh.

Rritja e këtyre të ardhurave, në krahasim me një vit më parë, u ndikua nga:

- ✓ Rritja e aktivitetit ekonomik në të gjithë sektorët e ekonomisë, veçanërisht e të ardhurave nga turizmi;
 - ✓ Rritja e volumit të importeve;
 - ✓ Niveli i lartë i inflacionit gjatë vitit 2022;
 - ✓ Rritja e çmimeve, në veçanti e energjisë elektrike dhe karburanteve;
 - ✓ Rritja e kërkesës së brendshme dhe të jashtme;
 - ✓ Rritja e ndjeshme e pagës minimale dhe rritja e numrit të të punësuarve, që ndikuan në rritjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore;
 - ✓ Përmirësimi i administrimit fiskal nga administratat tatimore e doganore, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të procesit të fiskalizimit, si dhe forcimit të kontrollit mbi deklaratat tatimore, bazuar në kriteret e riskut.
- *Të ardhurat nga fondet speciale* përbëjnë 21.4 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 101.5 për qind në krahasim me planin, me një rritje prej 1.8 miliardë lekësh.
 - *Të ardhurat nga pushteti vendor* përbëjnë 4.8 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 100 për qind në krahasim me planin.
 - *Të ardhurat jotatimore* përbëjnë 3.8 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 89 për qind, me një mosrealizim prej 2.8 miliardë lekësh.
 - *Të ardhurat nga grantet* përbëjnë 1.7 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 79.3 për qind, me një mosrealizim prej 2.5 miliardë lekësh.

6. Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit në përputhje me prioritetet.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2022, arritën nivelin 651 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 97.6 për qind të planit. Në krahasim me një vit më parë, këto shpenzime u rritën me 55.1 miliardë lekë ose 9.2 për qind.

Struktura e shpenzimeve të përgjithshme pësoi ndryshime gjatë vitit, në krahasim me planin fillestar, për të përballuar efektet e procesit të rindërtimit, si dhe të mbështetjes ndaj krizës së sektorit energjitik.

Realizimi i shpenzimeve, sipas grupeve kryesore, rezulton si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* përbëjnë 76.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime arritën vlerën 500 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 100.3 për qind në krahasim me planin. Në krahasim me një vit më parë, këto shpenzime u rritën me 38.9 miliardë lekë ose 8.4 për qind. Niveli i këtyre shpenzimeve ndaj PBB, në vitin 2022, ishte 23.4 për qind e PBB, nga 24.8 për qind e PBB që ishin një vit më parë.

- *Shpenzimet kapitale* përbëjnë 17.2 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime, për vitin 2022, arritën nivelin 112.1 miliardë lekë, i cili është 93.4 për qind e planit. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet kapitale u reduktuan me 15.9 miliardë lekë ose 12.2 për qind.

7. Orientimi i investimeve publike drejt sektorëve prioritarë të ekonomisë.

Shpenzimet kapitale të vitit 2022 kishin prioritet rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019, kryesisht në fushat e arsimit, infrastrukturës publike dhe strehimit. Gjithashtu, u mbështetën me prioritet sektorët e infrastrukturës së ujësjellës kanalizimeve, transportit rrugor, mbrojtjes etj.

Gjatë vitit 2022 u financuan dhe u mbyllën rreth 230 kontrata investimesh me financim të brendshëm, me vlerë të plotë të projekteve prej rreth 35 miliardë lekësh. Këto investime u kryen në fushat e transportit rrugor; ujësjellës-kanalizimeve; menaxhimit të mbetjeve; rikonstruksionit të qendrave spitalore, poliklinikave e qendrave shëndetësore, argjaturave të lumenjve, sistemeve të mbrojtjes e kompjuterike, mjediseve të punës për drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit, rikonstruksioneve e ndërtimeve të shkollave dhe ambienteve sportive; ngritjes së infrastrukturës turistike; përmirësimit të efikasitetit të energjisë, si dhe disa projekteve në fushat kulturore e të strehimit social.

8. Vazhdimi i zbatimit të programit të rindërtimit ishte një ndër prioritetet e buxhetit 2022.

Programi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 u zbatua në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore.

Fondi i planifikuar për vitin 2022, për programin e rindërtimit, ishte 32.4 miliardë lekë, i destinuar për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara për vitin 2021, si dhe për projektet e reja. Të ardhurat nga grantet janë një burim tjetër, të cilat rrisin në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet për fondin e rindërtimit.

Shpenzimet faktike për rindërtimin ishin rreth 35.1 miliardë lekë, nga të cilat:

- Rreth 9.8 miliardë lekë ishin fonde të trashëguara nga viti 2021;
- Rreth 25.3 miliardë lekë ishin fonde të akorduara gjatë vitit 2022.

Këto fonde u përdorën nga:

- Njësitë e qeverisjes qendrore 8.4 miliardë lekë;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore 26.7 miliardë lekë.

Përmes këtyre fondeve:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit përdori rreth 8.1 miliardë lekë për zbatimin e projekteve të zhvillimit rajonal dhe vendor;

- Agjencitë e tjera qendrore punuan për rindërtimin e Godinës së Institutit të Ndërtimit, rikonstrukcionin e objekteve të ish Repartit RENE, rikonstrukcionet dhe ndërtimet për institucionet e SHISH, si dhe hartimin e disa planeve vendore;
- Rreth 11 300 mijë familje u akomoduan në apartamente me qira të subvencionuar nga shteti;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore shpenzuan rreth 20.9 miliardë lekë, të cilat përbënin rreth 78.5 për qind të fondeve të akorduara.

9. Thellimi i mëtejshëm i decentralizimit fiskal.

Fokusi kryesor i pushtetit vendor, gjatë vitit 2022, ishte vazhdimi i konsolidimit të menaxhimit financiar në nivel vendor, duke synuar thellimin e reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimin fiskal. Disa nga arritjet më të rëndësishme në menaxhimin financiar vendor, gjatë vitit 2022, ishin:

- Rritja e të ardhurave tatimore të pushtetit vendor. Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura u rritën me rreth 1 miliardë lekë ose 3.6 për qind. Në krahasim me planin, këto të ardhura u realizuan në masën 100 për qind;
- Rritja e mbështetjes nga buxheti qendror për pushtetin vendor, në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale;
- Rritja e shpenzimeve të pushtetit vendor, të cilat në vitin 2022 u rritën me 6.1 miliardë lekë ose 11.6 për qind në krahasim me një vit më parë.

Sipas strukturës, në shpenzimet e pushtetit vendor vërehet:

- tendenca pozitive dhe e qëndrueshme e shpenzimeve kapitale, si dhe zgjerimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e aseteve që zotërojnë këto njësi;
- rritja e qëndrueshme e shpenzimeve të personelit, për të përballuar kompetencat në rritje në drejtim të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- rritja e shpenzimeve për subvencione, për të mbështetur zhvillimin ekonomik të zonës nën juridiksionin e tyre.

Relatori u ndal edhe në gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga raporti i KLSH. KLSH ka audituar përputhshmërinë e hartimit, miratimit, zbatimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2022.

Opinioni i përgjithshëm i auditimit është si më poshtë:

“Me përjashtim të disa situatave të theksuara në raportet përfundimtare të auditimit, procedurat për përgatitjen, miratimin dhe ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit zbatohen përgjithësisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe dispozitat rregullative në fuqi. Përkatësisht, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve dhe transfertave, si dhe planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, me disa problematika të evidentuara në këtë Raport, janë

në përputhje me shumat dhe dedikimet e përcaktuara në buxhetet e miratuara të njërive shpenzuese buxhetore.”

Më tej, relatori theksoi se KLSH, gjatë veprimtarisë audituese ka konstatuar raste të shkeljeve ligjore apo edhe dëm ekonomik në buxhetin e shtetit. KLSH ka kërkuar zhdëmtimin në masën 100 për qind të vlerës së dëmit ekonomik. Të gjitha institucionet buxhetore duhet të analizojnë rekomandimet e KLSH dhe duhet të zbatojnë masat pëkatëse ligjore ndaj personave përgjegjës.

* * *

Gjatë diskutimit anëtarët e Komisionit kërkuar informacion më të plotë për disa çështje të lidhura me buxhetin faktik 2022 dhe konstatimet e KLSH. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë paraqitën informacionet e kërkuara nga anëtarët e Komisionit për çështjet si më poshtë:

Së pari, lidhur me konstatimin e KLSH për rishpërndarjen e disa fondeve në tabelën fiskale, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas mbylljes së vitit buxhetor dhe pa miratimin e Kuvendit, duke cenuar cilësinë e planifikimit dhe nivelin e realizimit të planit, si dhe duke mos respektuar procedurat ligjore:

Të gjitha ndryshimet në buxhet janë bërë bazuar në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke argumentuar nevojën dhe urgjencën. Këto ndryshime janë miratuar me akte normative dhe me ligj. Në fund të vitit është bërë një rishpërndarje e fondit rezervë dhe detyrimeve kontingjente, vlera e të cilave është miratuar me akt normativ dhe me ligj.

Fondi rezervë është krijuar në fillim të vitit, bazuar në ligjin organik të buxhetit, i cili përcakton se:

“Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor, deri në masën 3 për qind të vlerës totale të fondeve të miratuara.

Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi i kontingjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.”.

Në fillim të vitit, fondi rezervë dhe i kontingjencës është pasqyruar në tabelën fiskale i plotë, në zërin për fondin rezervë dhe kontingjencën.

Gjatë vitit, ky fond është shpërndarë ndërmjet zërave të shpenzimeve buxhetore, sipas përcaktimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave. Sipas metodologjisë së buxhetit të ndjekur ndër vite, në tabelën fiskale të fundit të vitit është pasqyruar shpërndarja sipas zërave e fondit rezervë dhe kontingjencës, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave. Totali i vlerës së këtyre zërave është i barabartë me fondin rezervë dhe kontingjencën e parashikuar në ligj.

Së dyti, lidhur me konstatimin e KLSH se Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka miratuar dhe përcjellë në Kuvend pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit:

Zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë informoi Komisionin se këto pasqyra janë pjesë e paketës ligjore të buxhetit faktik, të paraqitur në Kuvend.

Së treti, lidhur me pyetjen nëse ka apo jo një certifikimin nga KLSH për treguesit e të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit buxhetor:

Përfaqësuesi i KLSH informoi Komisionin se janë certifikuar treguesit e të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit buxhetor, pavarësisht disa problematikave të evidentuara në raportin e këtij viti.

Së katërti, lidhur me masat për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të njësisve të qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore:

Në vitin 2013 stoku i detyrimeve të prapambetura ishte i lartë, duke ndikuar në rritjen e stokut të borxhit publik. Për reduktimin e tyre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me FMN, hartuan Strategjinë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura. Kjo strategji përcakton që institucionet buxhetore të përdorin çdo burim për financimin e detyrimeve të prapambetura dhe më pas për detyrimet e tjera buxhetore.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar disa rregullore, ka koordinuar punën me institucionet e tjera, si dhe ka ndjekur në vijimësi punën për reduktimin e stokut të detyrimeve të prapambetura. Ky stok ka ardhur në ulje nga viti në vit.

Avancim serioz është bërë nëpërmjet pasqyrit të detyrimeve të prapambetura, nga të gjitha institucionet, në sistemin qendror të thesarit, me qëllim krijimin e mundësisë për monitorimin e tyre.

Gjithashtu, është miratuar dhe po zbatohet edhe një plan për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, zbatimi i të cilit ndiqet nga struktura e thesarit.

Së pesti, lidhur me konstatimin e KLSH se në auditimin e brendshëm ka vakanca dhe ineffiçenca të burimeve njerëzore:

Nga anëtarët e Komisionit u theksua se është e nevojshme të forcohet kontrolli, nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat, mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm të qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore. Në radhë të parë, duhet të evidentohen dhe plotësohen vendet vakante në strukturat e auditimit të brendshëm. Më pas, duhet të forcohet kontrolli për rritjen e efikasitetit të tyre.

Së gjashti, lidhur me konstatimin e KLSH se një pjesë e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore nuk plotësojnë detyrimin për identifikimin dhe analizën e risqeve, e cila është një ndër kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm:

Ky konstatim i raportit të KLSH është një ndër gjetjet e raportit vjetor të kontrollit të brendshëm, të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Kjo ministri bën një vetëvlerësim të veprimtarisë së të gjitha strukturave të saj. Bazuar në këtë vetëvlerësim, institucioneve u lihen rekomandimet përkatëse. Në vendin tonë këto institucione janë relativisht të reja, ligjet janë relativisht të reja, ndaj po punohet në vazhdimësi për të plotësuar më mirë detyrimet e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Së shtati, lidhur me pyetjen se në çfarë niveli janë marrë në konsideratë rekomandimet e KLSH, të vitit të mëparshëm, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

Në raportimin që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kryer pranë BE, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për kapitullin 32 “Kontrolli financiar”, është theksuar se gjetjet e KLSH në Shqipëri, krahasuar edhe me vendet e tjera, janë pranuar në masë shumë të lartë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e tjera. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të KLSH kryhet rregullisht nga këto institucione.

Së teti, lidhur me konstatimin e KLSH se ka mospërputhje të të dhënave midis Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe drejtorive të përgjithshme të tatimeve e doganave:

Çdo e ardhur, e mbledhur nga tatimet dhe taksat, është raportuar në buxhet. Ka pasur disa probleme të vogla teknike nga alokimet e thesarit, sipas strukturës së të ardhurave dhe strukturës së tatimeve, siç janë gjobat apo kamatëvonesat. Këto janë ndryshime të vogla teknike dhe po ndiqen. Borxhi në TVSH është zero.

Së nënti, lidhur me risqet e buxhetit faktik 2022:

Risqet në buxhetin e vitit 2022 janë risqe të faktuara. Risqet kanë qenë të larta, pasi kishim rritjen e çmimeve, krizën e energjisë, agresionin rus mbi Ukrainën. Këto risqe tashmë janë brenda buxhetit faktik.

Së dhjeti, lidhur me punën e kryer për strategjinë e mbledhjes së të ardhurave dhe zgjerimin e bazës tatimore:

Në vitin 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim të ngushtë me FMN, hartoi një projekt strategji të ardhurash, e cila kishte 2 komponentë: komponentin e politikës dhe komponentin e miradministrimit. Në komponentin e miradministrimit, po punohet me administratat për të përmirësuar luftën kundër informalitetit dhe rritur miradministrimin. Pjesë e politikave ka qenë kryesisht heqja e përjashtimeve.

Vitet 2020-2021 nuk kanë qenë vite të përshtatshme për të rritur të ardhurat, prandaj Ministria e Financave dhe Ekonomisë është fokusuar kryesisht në heqjen e përjashtimeve, si dhe në forcimin e administrimit. Strategjia do të punohet me të gjithë partnerët dhe me BE-në dhe synon të ndihmojë në luftën kundër informalitetit, si dhe në forcimin e administrimit fiskal.

Me ligjin e ri për tatimin mbi të ardhurat u zgjerua baza e tatimit me faza. Në ligjin e akcizave, të miratuar në vitin 2021, u zgjerua baza e tatimit. Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, në vitin 2023, janë rritur me 4 për qind të PBB, krahasuar me 10 vjet më parë. Rritja do vijë nga zgjerimi i bazës së tatueshme dhe nga përmirësimi i elementëve të tjerë të administrimit fiskal.

Anëtarët e Komisionit kërkojnë përmirësimin e mëtejshëm të punës së administrative tatimore e doganore për zgjerimin e bazës tatimore, si dhe rritjen e performancës së tyre. E rëndësishme është edhe vendosja e stabilitetit në ligjet fiskale, për të mos pasur shumë ndryshime ligjore.

Së njëmbëdhjeti, lidhur me konstatimin e KLSH se ka problematika në planifikimin dhe zbatimin e treguesve të buxhetit:

Disa anëtarë të Komisionit iu referuan konstatimeve të KLSH lidhur me disa problematika në planifikimin dhe zbatimin e treguesve të buxhetit, siç janë:

- Planifikimi i shpenzimeve kapitale, duke përqendruar një pjesë të konsiderueshme të tyre në muajt e fundit të vitit, ve në vështirësi zbatimin e buxhetit, sipërmarrjen dhe targetin e inflacionit;
- Problematika janë konstatuar nga KLSH edhe në planifikimin e të ardhurave;
- Në disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore konstatohen mosrealizime në krahasim me planin;
- Ndryshimet e shpeshta të buxhetit me akt normativ dhe mosrealizimet në disa zëra tregojnë që buxheti nuk është linear dhe reflektiv.

Anëtarët e Komisionit kërkojnë përmirësimin e procesit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, me qëllim forcimin e disiplinës financiare. Gjithashtu, ata kërkojnë forcimin e kontrollit mbi zbatimin e kontratave të koncesioneve/PPP, si dhe rritjen e efikasitetit të tyre.

Duhet të përmirësohet më tej harmonizimi i punës midis institucioneve të ndryshme gjatë hartimit dhe zbatimit të buxhetit.

Komisioni vuri theksin në rëndësinë e ngritjes së nënkomisionit për zbatimin e buxhetit të shtetit, i cili duhet të jetë aktiv, duke synuar zgjidhjen e problematikave të identifikuara gjatë zbatimit të buxhetit.

Rëndësi duhet t'i kushtohet zbatimit të rekomandimit të përfaqësuesve të BE-së për ngritjen e një strukture ekzekutive, e cila të studiojë dhe analizojë politikat buxhetore, para se të hartohen e miratohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

V. Përfundim.

Mbështetur në argumentet se projektligji “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2022” dhe raporti vjetor i konsoliduar të buxhetit, bashkëlidhur tij:

- Janë në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Janë hartuar dhe po shqyrtohen në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- Priten të ndihmojnë në përmirësimin e procesit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit në vendin tonë;

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORI

Vullnet SINAJ

KRYETARI

Eduard SHALSI